LIGJ
Nr.9927, datë 9.6.2008

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 3, DATË 28.5.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR DËRGIMIN NË REPUBLIKËN E ÇADIT DHE NË REPUBLIKËN E AFRIKËS QENDRORE, SI KONTRIBUT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË NJË KOMPANIE TË FORCAVE TË ARMATOSURA, PËR TË MARRË PJESË NË OPERACIONIN "EUFOR TCHAD/RCA" TË BASHKIMIT EUROPIAN"

Në mbështetje të neneve 12 pika 3, 78, 83 pika 1 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr.3, datë 28.5.2008, i Këshillit të Ministrave "Për dërgimin në Republikën e Çadit dhe në Republikën e Afrikës Qendrore, si kontribut i Republikës së Shqipërisë, të një kompanie të Forcave të Armatosura, për të marrë pjesë në operacionin "EUFOR TCHAD/RCA" të Bashkimit Europian".

Shpallur me dekretin nr.5783, datë 30.6.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

AKTNORMATIV
Nr. 3, datë 28.5.2008

PËR DËRGIMIN NË REPUBLIKËN E ÇADIT DHE NË REPUBLIKËN E AFRIKËS QENDRORE, SI KONTRIBUT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË NJË KOMPANIE TË FORCAVE TË ARMATOSURA, PËR TË MARRË PJESË NË OPERACIONIN "EUFOR TCHAD/RCA", TË BASHKIMIT EUROPIAN

Në mbështetje të neneve 12 pika 3 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Dërgimin në Republikën e Çadit dhe në Republikën e Afrikës Qendrore, të një kompanie të Forcave të Armatosura, në kuadër të kontributit të Republikës së Shqipërisë, në operacionin "EUFOR Tchad/RCA", të Bashkimit Europian, në zbatim të rezolutës nr. 1778, datë 25.9.2007, të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 2

Misioni i autorizuar i kompanisë së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë të jetë, si më poshtë vijon:

1. Sigurimi i Shtabit të Përgjithshëm të EUFOR-it, me vendndodhje në qytetin e N'Dajmenës, Republika e Çadit.

2. Patrullimi në rajonin e qytetit të N'Dajmenës.

3. Shoqërimi dhe sigurimi i personaliteteve civile dhe ushtarake, të rëndësishme, nga aeroporti në kamp, e anasjelltas.

4. Shoqërimi dhe sigurimi i trupave, që mund të lëvizin nga kampi, që ndodhet në qytetin N'Dajmena, për kampin, që ndodhet në qytetin Abéché, përfshirë edhe sigurimin e këtyre trupave, sipas situatës operacionale.

Neni 3

Ushtarakët, që do të marrin pjesë në operacionin "EUFOR Tchad/RCA", për ditët e qëndrimit në këtë operacion, veç pagës mujore marrin, për vështirësi shërbimi, edhe një shpërblim ditor, në masën, që do të caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 4

Shpenzimet për pjesëmarrjen në operacionin "EUFOR Tchad/RCA", të kompanisë së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, mbështetur edhe në marrëveshjet ndërkombëtare, të lidhura për këtë qëllim.

Neni 5

Ky akt normtiv hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha